



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1732/2 Prot.

Tiranë, më 24 / 12 / 2018

V E N D I M

Nr. 259, Datë 24 / 12 / 2018

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën me nr.188, datë 14.12.2018, të Shoqatës “Ilinden¹”, kundër z.A. Ll me objekt pretendimin për diskriminim “për shkak të etnisë²”.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi³,

KONSTATOI:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Nga parashtimet e paraqitura nga Shoqata “Ilinden”, përfaqësuar nga z.N. Gj, në cilësinë e kryetarit të saj, pretendohet se z.A. Ll në një shkrim të tij, botuar në disa portale online, me datë 08.12.2018 ka përdorur terma ofenduese dhe ka gënjyer lidhur me faktin se z.L. N, bashkëshorti i Ministres së Arsimit, znj.L. N, është themelues i Shoqatës maqedonase “Ilinden” dhe Kryetar Nderi i saj. Njëherësh z.A. Ll ka akuzuar pa fakte lidhur me financimin e kësaj shoqate, duke u shprehur se: “Shoqata “Ilinden” është financuar nga Gruevski dhe Sashoja”. Këto sajesa dhe fyrije, shoqata “Ilinden” i konsideron baltosje dhe fyrije duke fabrikuar sajesa dhe nxit urrejtjen kundër minoritetit maqedonas në Republikën e Shqipërisë.

¹ Shoqata “Ilinden”, është Organizatë Jo Fitimprurëse, dhe është regjistruar si person juridik, me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr.2473, datë 06.02.2009.

² Si pjesë e minoritetit kombëtar maqedonas në Republikën e Shqipërisë.

³ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Në përfundim të ankesës, përfaqësuesi i shoqatës “Ilinden” ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi: *“Të marrë masë me gjobë dhe të detyrojë z.A. Ll të tërheqë artikullin e shkruar prej tij nga portalet e mediave online”*.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Neni 1 i Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” përcakton se *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*. Pra siç shihet etnia gëzon mbrojtje të veçantë nga sjelljet diskriminuese apo personat që e nxisin atë, pavarësisht se kush është subjekti që mban këtë sjellje.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi si të një autoriteti publik, ashtu edhe çdo personi fizik apo juridik që merr pjese në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë.

Për sa më lart, për të vijuar me verifikimin e fakteve të pretenduara nga subjekti ankues, lidhur me diskriminimin e minoritetit maqedonas në Republikën e Shqipërisë përmes termave të përdorur nga z.A. Ll në shkrimin e tij në disa portale online, subjekti ankues i referohet një shkrimi të datës 08.12.2018.

Nga verifikimi rezultoi se shkrimi i z.A. Ll është botuar në disa portale online në datën 08.12.2018⁴, dhe se konkretisht në të citohet: *“...Shqipëria në rrezik nga filogrekët në qeverinë e E. R 2, L. N e ka burrin sllavo-maqedonas, L. N, një ekstremist sllav që ka predendime territoriale ndaj Shqipërisë, themelues dhe Kryetar Nderi i shoqatës sllave, “Ilinden” e financuar prej disa vitesh nga Gruevski dhe Sashoja”*.

Në referim të ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, vërehet se pretendimet e tij janë bazuar në përdorimin e një fjalori fyës dhe ofendues të z.A. Ll në drejtim të z.L. N, si dhe shpifjeve dhe

⁴<http://www.kohajone.com/2018/12/08/lindita-nikolla-e-ka-burrin-ekstremist-sllav-historiani-shqiperia-ne-rrezik/>,
<http://www.albeu.com/shqiperi/lindita-nikolla-e-ka-burrin-ekstremist-sllav-historiani-shqiperia-ne-rrezik/435863/>,
<http://lajmifundit.al/2018/12/deklarata-bombe-e-historianit-lindita-nikolla-e-ka-burrin-ekstremist-sllav/>,

deforminit të fakteve lidhur me financimin e Shoqatës “Ilinden”, si dhe të faktit që z.L. N është themelues i kësaj shoqate dhe Kryetar Nderi i saj.

Referuar për sa më sipër Komisioneri vlerëson se përdorimi i gjuhës fyese dhe shpifja parashikohen si vepra penale në nenin 119 dhe 120 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin nr.7895, datë 27.01.1995, i ndryshuar.

Në nenin 119 parashikohet se: *“Fyerja e qëllimshme e personit përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në një milion lekë. Po kjo vepër, kur kryhet botërisht, në dëm të disa personave ose më shumë se një herë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në tre milionë lekë”*.

Në nenin 120 parashikohet se: *“Përhapja e qëllimshme e thënieve, si dhe çdo informacion tjetër, duke e ditur se janë të rreme, që çënojnë nderin dhe dinjitetin e personit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në një milion e pesëqind mijë lekë. Po kjo vepër, kur kryhet botërisht, në dëm të disa personave ose më shumë se një herë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në tre milionë lekë”*.

Lidhur me sa më sipër, palët kanë të drejtë për të kërkuar dhe shpërblimin e dëmit konform nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.

Në lidhje me ankesën e bërë nga subjekti ankues për sa i përket “fyerjes” dhe “shpifjes” nga ana e z.A. Ll, Komisioneri vëren se kjo kërkesë nuk bën pjesë në kompetencat dhe fushën e veprimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi të përcaktuara shprehimisht në dispozitat e ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/b të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se *“Ankesa nuk pranohet nëse është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji”*, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 33, pika 4/b, neni 33, pika 10, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës për shkak se është haptazi e pabazuar në dispozitat e ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurave Administrative.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha: Shërbime

Shkaku: Etnia